

## Vendim nr. 18 datë 24.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 24.01.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 26 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **MERXHAN QERIMAJ**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-980, datë 12.03.2024 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi për një periudhë të gjatë kohe ka banuar në një banesë të dhënë me qira nga autoritetet shtetërore të kohës, të ndodhur në qytetin e Shkodrës. Për këtë pronë, bazuar në ligjin nr.

7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (ligji nr. 7698/1993), Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-Pronarëve pranë Bashkisë Shkodër (KKKP, Shkodër), me vendimin nr. 1600, datë 27.09.1996 (vendimi nr. 1600/1996), ka disponuar për kthimin e saj në favor të ish-pronarëve, trashëgimtarëve të tyre, duke u mbështetur edhe në përmbajtjen e vendimit nr. 337, datë 08.07.1946 (vendimi nr. 337/1946) të Këshillit të Përgjithshëm të Gjykatës së Lartë.

2. Me pretendimin se, referuar vendimit nr. 337/1946 të Këshillit të Përgjithshëm të Gjykatës së Lartë, ish-pronarët e kishin humbur pronësinë nga shitja në ankand e pronës, ndaj ajo nuk duhej të trajtohej sipas ligjit nr. 7698/1993, por sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (ligji nr. 7652/1992), kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë, duke kërkuar pavlefshmërinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 735, datë 20.06.2002, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit, duke i vlerësuar si të pabazuara në prova dhe ligj pretendimet e tij në lidhje me pronësinë dhe kthimin e pronës ish-pronarëve dhe gjetur në këtë mënyrë të drejtë vendimin nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 295, datë 27.10.2003, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1685, datë 20.09.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Në datën 25.01.2006, në lidhje me vendimin nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër, kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake të procedimit penal të regjistruar për këtë kallëzim, me vendimin e datës 07.11.2006, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria Shkodër*), ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk përbënte vepër penale. Disa kohë më pas, Prokuroria Shkodër ka rifilluar hetimet, por, sërish, me vendimin e datës 08.02.2008, ka vendosur pushimin e procedimit penal për të njëjtin shkak. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 27, datë 09.05.2009, ka vendosur vazhdimin e hetimeve. Në vijim, me vendimin e datës 04.02.2010, Prokuroria Shkodër ka vendosur përsëri pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se ndonëse procedura e miratimit të vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër dhe ajo e regjistrimit të tij janë bërë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, ndaj personave përgjegjës nuk mund të ushtrohej ndjekja penale për shkak të parashkrimit të saj sepse kanë kaluar më shumë se 10 vjet nga miratimi dhe regjistrimi i vendimit.

4. Në datën 25.04.2012 kërkuesi ka paraqitur sërish padi në gjykatë, duke kërkuar tashmë pavërtetësinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër dhe fshirjen nga regjistrat hipotekarë të të gjitha shënimeve të bëra në bazë të këtij vendimi, me pretendimin se është marrë mbi dokumente të falsifikuara për origjinën e pronës, në mashtrim dhe në shkelje flagrante të ligjit, çka, sipas tij, provohej nga vendimi i Prokurorisë Shkodër i datës 04.02.2010 për pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 2214 (6998), datë 21.09.2012, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se, pavarësisht objektit të padisë për pavërtetësinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër, në thelb, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me ligjshmërinë e këtij vendimi, pretendime këto që janë shqyrtuar më parë në themel nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke qenë kështu përpara “gjësë së gjykuar”. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 1289, datë 17.10.2014, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-980, datë 12.03.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Në datën 05.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim nenin 451/a të KPC-së lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar”. Ndonëse çështjet duken të njëjta, ato kanë shkaqe të ndryshme, pasi padia e parë bazohej në nenin 32, shkronja “a”, të KPC-së dhe shkaku ishte se prona duhej të trajtohej sipas ligjit nr. 7652/1992 dhe jo sipas ligjit nr. 7698/1993, ndërsa padia e dytë bazohej në nenin 32, shkronja “c”, të KPC-së dhe shkaku lidhej me faktin se vendimi nr. 1600/1996 është i pavërtetë si rrjedhojë e falsifikimit, ndaj është inekzistent. Gjykatat nuk kanë analizuar provën e re shkresore që lidhej me gjetjet e prokurorit në vendimin për pushimin e procedimit penal.

- 7.2. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka ligjëruar vendimet e gjykatave të faktit, të cilat kanë zbatuar gabim nenin 451/a të KPC-së.
- 7.3. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për zëvendësimin procedural të të paditurve, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) me Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), si dhe të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (ZVRPP, Shkodër) me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtorinë Rajonale Shkodër. Po kështu, ajo gjykatë nuk e ka njoftuar as për datën e gjykimit dhe as për vendimin e arsyetuar të saj.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesit

8. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, rezulton se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili praktikisht ka lënë në fuqi vendimmarrjen e dy gjykatave të faktit të vëna në lëvizje nga vetë ai. Në këto rrethana, ai nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion, ndaj e ka përmbushur edhe këtë kriter, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, duke zbatuar këtë standard, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 12.03.2024 dhe, sipas komunikimit elektronik me atë gjykatë, rezulton se ai është bërë i disponueshëm për palët në datën 13.09.2024, kur është publikuar në faqen zyrtare të saj, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 05.12.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në drejtim të legjitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e së drejtës për t’u njoftuar nga Gjykata e Lartë, duke parashtruar tre argumente: (i) se nuk është njoftuar për datën e gjykimit; (ii) nuk është njoftuar për vendimin e arsyetuar; (iii) nuk është njoftuar për zëvendësimin procedural të të paditurve, AKKP-së me ATP-në, si dhe të ZVRPP, Shkodër me ASHK-në, Drejtorinë Rajonale Shkodër. Lidhur me mungesën e njoftimeve të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë-dhe të zëvendësimit procedural të të paditurve për shkak të ligjit, kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë pasojë konkrete të shkaktuar atij në kuadër të procesit të zhvilluar nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit për këto argumente nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për argumentin se nuk është njoftuar për datën e gjykimit, pretendimi i kërkuesit do të analizohet në vijim.

14. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat kanë zbatuar gabim nenin 451/a të KPC-së të lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar” dhe nuk kanë analizuar provën e re shkresore që lidhej me gjetjet e prokurorit në vendimin për pushimin e procedimit penal. Nisur nga thelbi i këtyre argumenteve, Kolegji çmon t’i analizojë ato në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

15. Për sa më lart, pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor do të shqyrtohen në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për t’u njoftuar, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

16. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim nenin 451/a të KPC-së të lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar”. Sipas tij, ndonëse çështjet duken të njëjta, ato kanë shkaqe të ndryshme, pasi padia e parë bazohej në nenin 32, shkronja “a”, të KPC-së dhe shkakut ishte se prona duhet të trajtohej sipas ligjit nr. 7652/1992 dhe jo sipas atij nr. 7698/1993, kurse padia e dytë bazohej në nenin 32, shkronja “c”, të KPC-së dhe shkakut lidhej me faktin se vendimi nr. 1600/1996 është i pavërtetë si rrjedhojë e falsifikimit, ndaj është inekzistent. Po kështu, gjykatat nuk kanë analizuar provën e re shkresore që lidhej me gjetjet e prokurorit në vendimin për pushimin e procedimit penal. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka ligjëruar vendimet e gjykatave të faktit.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik.

18. Gjykata ka pohuar se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e funksioni i vendimit gjyqësor është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar duke u dhënë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me këtë arsytim, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 72, datë 17.10.2024; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me arsytimin e vendimeve të mospranimit të rekursit, jurisprudenca kushtetuese është shprehur se dhoma e këshillimit njihet dhe si faza seleksionuese për shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit dhe duke i lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura

në ligj (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 26, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkuesi, pasi ka banuar për shumë vite si qiramarrës nga shteti, ka pretenduar pasjen e së drejtës së privatizimit të banesës, ndërkohë që ndërtesa është bërë objekt trajtimi nga KKKP-ja, Shkodër, e cila, bazuar në ligjin e kohës për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, me vendimin nr. 1600/1996 ia ka kthyer atë trashëgimtarëve të ish-pronarëve. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, me pretendimin se ish-pronarët e kishin humbur pronësinë nga shitja në ankand e pronës dhe për këtë arsye ajo nuk duhej të trajtohej sipas ligjit nr. 7698/1993, por sipas ligjit nr. 7652/1992, kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë, duke kërkuar pavlefshmërinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër. Padia e tij është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 735, datë 20.06.2002, e cila i ka vlerësuar si të pabazuara në prova dhe ligj pretendimet e tij në lidhje me pronësinë dhe kthimin e pronës ish-pronarëve, duke e gjetur të drejtë vendimin nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është bërë përfundimtar, pasi gjykata e apelit e ka lënë atë në fuqi, kurse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

22. Pavarësisht kësaj, në lidhje me vendimin nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër, kërkuesi në vijim, ka paraqitur kallëzim penal, mbi të cilin Prokuroria Shkodër ka regjistruar një procedim penal, i cili përfundimisht është pushuar me vendimin e prokurorit të datës 04.02.2010. Në vlerësimin e prokurorit, vendimi nr. 1600/1996 i KKKP-së, Shkodër nuk është përputhje me ligjin, pasi mungon dokumenti i shtetëzimit, shpronësimit ose konfiskimit të pronës, nuk ka vërtetim të rregullt pronësie, nuk ka dokument të rregullt teknik nga zyra e urbanistikës, mungon deklarata për efekt të nenit 24 të

ligjit nr. 7698/1993, përveçse për administrimin dhe arkivimin e dosjes nuk janë respektuar rregullimet ligjore. Edhe regjistrimi i pronës nuk është bërë në përputhje me ligjin, pasi vendimi i KKKP-së, Shkodër nuk është regjistruar brenda 30 ditëve, por rreth 2 vjet pas marrjes së tij. Në përfundim, ai ka konkluduar se ndonëse procedura e miratimit të vendimit të KKKP-së, Shkodër dhe ajo e regjistrimit të tij janë bërë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, ndaj personave përgjegjës nuk mund të ushtrohej ndjekja penale për shkak të parashkrimit të saj, pasi kanë kaluar më shumë se 10 vjet nga miratimi dhe kryerja e të gjitha veprimeve administrative ndaj këtij vendimi.

23. Në vijim, duke u bazuar në përfundimet e prokurorisë, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës me padi, tashmë duke kërkuar pavërtetësinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër dhe fshirjen nga regjistrat hipotekarë të shënimeve të bëra mbi bazën e tij. Sipas kërkuesit, referuar fakteve dhe prova të reja, vendimi i KKKP-së, Shkodër është marrë mbi dokumente të falsifikuara për origjinën e pronës, në mashtrim dhe në shkelje flagrante të ligjit, çka e bënte atë të pavërtetë e të pavlefshëm dhe që nuk mund të sillte efekte juridike në favor të të paditurve. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas gjykatës, pavërtetësia dhe paligjshmëria janë koncepte juridike të ndryshme dhe, në rastin konkret, pavarësisht objektit të padisë për pavërtetësinë e vendimit nr. 1600/1996 të KKKP-së, Shkodër, pretendimet në thelb të kërkuesit kanë të bëjnë me ligjshmërinë e këtij vendimi, ndërkohë që këto pretendime janë shqyrtuar më parë në themel nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke qenë kështu përpara “gjësë së gjykuar”, sipas nenit 451/a të KPC-së. Po sipas saj, kërkuesi (paditësi) nuk paraqiti ndonjë pretendim të ri në këtë drejtim. Për sa i përket vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, gjykata ka vërejtur se ai nuk është i detyrueshëm për të, sikurse është vendimi i gjykatës i dhënë më parë për të njëjtat palë.

24. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo, duke arsyetuar se edhe vlerësimet juridike të prokurorit në vendimin e pushimit të procedimit penal nuk mund të merren në konsideratë për sa kohë në zbatim të dispozitave të ligjit procedural, të neneve 451-451/a të KPC-së, mosmarrëveshja në gjykim mes palëve është zgjidhur më parë me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

25. Për rekursin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, nuk identifikohet asnjë shkak lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, nuk evidentohen shkelje të natyrës procedurale në vendimmarrjen e gjykatave



të faktit, që mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit dhe nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve, nuk rezulton që vendimet e gjykatave të bien ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Civil ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, si dhe asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga kërkuesi në rekurs.

26. Nga sa më lart, në analizë të përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vë në dukje se pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me faktin se gjykatat, duke mos i pranuar padinë, ankimin dhe rekursin, nuk i kanë dhënë zgjidhje kërkimit të tij për pavërtetësinë e vendimit të KKKP-së, Shkodër, për shkak të paligjshmërisë së tij të provuar me vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal, duke u mjaftuar me faktin se ligjshmëria e atij vendimi është gjykuar më parë dhe përbënte “gjë të gjykuar”.

27. Për sa i takon parimit të “gjësë së gjykuar”, Gjykata ka theksuar se ky parim përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t’u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit, mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 28, datë 18.05.2023; nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë pikë, Kolegji rithekson se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nën këtë optikë, duke u ndalur tek të dhënat e dy proceseve gjyqësore, Kolegji konstaton se në të dyja rastet ai (procesi) është vënë në lëvizje nga kërkuesi, ku në rastin e parë është kërkuar pavlefshmëria e vendimit të KKKP-së, Shkodër mbi pretendime për paligjshmëri të tij, ndërsa në rastin e dytë është kërkuar pavërtetësia e atij vendimi po mbi pretendime për paligjshmëri të tij, referuar për këtë vlerësimeve të prokurorit në vendimin e pushimit të procedimit penal. Në procesin e dytë, gjykatat e faktit kanë arsyetuar se pretendimet e kërkuesit për paligjshmërinë e vendimit të KKKP-së, Shkodër kishin marrë përgjigje me vendim gjyqësor përfundimtar, ndaj, në këtë aspekt, çështja përbënte “gjë të gjykuar”. Nga ana tjetër, po sipas tyre, paligjshmëria e vendimit nuk e bënte atë të pavërtetë dhe se vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal nuk ishte i detyrueshëm,

ndërsa ligjshmëria e vendimit të KKKP-së, Shkodër tashmë ishte zgjidhur me vendim gjyqësor përfundimtar.

29. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se në themel të të dyja proceseve gjyqësore, pavarësisht objektit të padive respektive, ka qenë ligjshmëria e vendimit të KKKP-së, Shkodër, me ndryshimin se në rastin e dytë pretendimet për paligjshmërinë e tij kërkuesi i ka mbështetur në një provë të re në vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Në vlerësimin e kësaj prove, gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se ajo nuk mund të shërbejë për të provuar paligjshmërinë e vendimit të KKKP-së, Shkodër, ligjshmëria e të cilit ishte zgjidhur tashmë me vendim gjyqësor përfundimtar, vendim i cili është i detyrueshëm për palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera, në kuptim të nenit 451/a të KPC-së. Nga ana tjetër, duke dalluar konceptet e pavërtetësisë së dokumentit me atë të paligjshmërisë së vendimit të pasqyruar në të, gjykatat e faktit kanë rrëzuar padinë e kërkuesit për pavërtetësinë e vendimit të KKKP-së, Shkodër, duke i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së parashtruar nga ai. Për këto përfundime të gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, nuk ka konstatuar zbatim të gabuar të tij, duke disponuar me arsyetim të kufizuar për mospranimin e rekursit të kërkuesit.

30. Për sa më lart, Kolegji çmon se gjykatat e zakonshme i kanë dhënë zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes së paraqitur nga kërkuesi, duke parashtruar mjaftueshëm argumente për atë mënyrë zgjidhjeje, ndërkohë që përcaktimi nga ato i fakteve dhe zbatimi i ligjit nuk duket arbitrar, në kuptimin që gabimi faktik ose ligjor i tyre të jetë aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar*

31. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën e gjykimin të çështjes së tij në dhomën e këshillimit.

32. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se është detyrë e

palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 13, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (*neni 482 i KPC-së*) ose në prani të palëve (*neni 482/a i KPC-së*), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në mjediset e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit (*neni 482/a, pika 2, i KPC-së*).

34. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e kërkuarit. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, kategoria “Çështje civile”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, rezulton se në datën 26.02.2024 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 12.03.2024, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, listë në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuarit. Gjithashtu, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual (kopje e dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë), rezulton se njoftimi për datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues është afishuar edhe në mjediset fizike të asaj. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, e cila mban datën 12.03.2024, është shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht, sipas ligjit, me anë të shpalljes publike në datën 26.02.2024 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përbërjen e trupit gjykues. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

35. Nga sa më sipër, në kushtet kur nga dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës (kopje e dosjes gjyqësore) nuk konstatohet që kërkuari ose përfaqësuesi të kenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit, Kolegji vlerëson se, pavarësisht se ligji procedural nuk përcakton në mënyrë të shprehur detyrim për Gjykatën e Lartë për njoftimin e palëve për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit në kuadër të verifikimit të kritereve të pranueshmërisë së tij, ajo gjykatë i ka njoftuar palët sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit që ligji procedural ka përcaktuar për të, duke u bërë të ditur atyre datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar është haptazi i pabazuar.

36. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.